Ai ka te drejte te marre pjese ne shitblerje ,procedura falimentimi ,te tjetersoje pasuri luajtshme dhe te paluajtshme ,te hape llogari rrjedhese ne banke shqiptare apo te huaj ,te perfaqesoje shoqerine prane organeve gjyqesore dhe ato administrative ,te punesoje apo largoje nga puna te punesuarit ne shoqeri..

I pajisur me autorizim nga Asamblea administratori mund ti kaloje keto kompetenca

Neni 22

Administratori zgjidhet nga Asamblea per nje afat dyvjecar .Kanditatura e tij nuk eshte e perseritshme ne rast se 40% e kapitalit fillestar te perfaqesuar nga nje ose me shume ortake nuk e mbeshtesin ate .

Administratori e pushon veprimtarine :

-Jep doreheqjen

- Perfundon afati dhe ai nuk rizgjidhet.
- Shkel rende e ne menyre te perseritur statutin ,aktin e themelimit dhe ligjet e shtetit shqiptar.

\- Neni 23

Ne rast te emerimit te nje administratori jo ortak ai ne marrdheniet me ortaket e te tretet ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjithe veprimtarine e administrimit ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet veprimeve qe jane ne perputhje me objektin e shoqerise , me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji dhe statuti ia japin shprehimisht ortakeve.

Administratori eshte pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve qofte per shkelje te statutit ose per faje te kryera gjate administrimit te tij.

Neni 24

Anetare I shoqerise quhet ai person I cili merr pjese ne kapitalin themelor te shoqerise me te drejten e tij te pronesise mbi pjeset e tij te njohura ligjerisht me aktet ligjore ,konform legjislacionit shqiptar.

Anetaresia ne pergjithesi eshte e drejte vetjake .

Kuotat e anetarit mund te transferohen me akte ndermjet anetareve te gjalle ,nga ortaku tek bashkeshorti dhe farefisi.Ato mund tu trasferohen dhe te treteve .Gjithmone ne keto raste kerkohet pelqimi I Asamblese se ortakeve.

Anetari I shoqerise nuk mund te jete si I tille ne me shume se nje shoqeri me te njejtin objekt.

Neni 25

Te drejtat e anetarit humbasin:

-Anetari largohet nga shoqeria me deshiren e vet.

-Zhvillon aktivitet te jashtem ekonomik qe bie ndesh dhe demton rende interesat e shoqerise apo I krijon asaj per perfitim personal situata renduese konkuruese.

Neni 26

Cdo anetar ka te drejte :

-Te zgjedhe e te zgjidhet ne organet e shoqerise.

-Te marre pjese ne veprimtarine prodhuese dhe shoqerore te shoqerise.

-Te gezoje te ardhurat (fitimin) qe rrjedh nga aktiviteti I shoqerise.

Neni 27

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje perveç dokumentacionit kontabel ose librave te tjere dhe Librin e Shoqerise ne te cilin shenohet emri I plote I ortakeve kapitali themeltar, si edhe vendimet e asamblese se ortakeve .

**PUNESIMET NE SHOQERI**

Neni 27

Kriteret e pergjitheshme te punesimit ,numri I tyre ,kufijte e pageses dhe detyrat e secilit ne shoqeri percaktohen nga ortaket .

Marredheniet e punes te punonjesit qe do te punesohet ne shoqeri, do te rregullohen nepermjet kontrates se punes ne perputhje me dispozitat ligjore e sidomos me kodin e punes .

Ne rastet kur shoqeria per nevojat e saj do te marre mjete me qera marredheniet do te rregullohen sipas dispozitave te kodit civil.

Neni 28

Shoqeria merr persiper te derdhi rregullisht te gjitha detyrimet , kontributet per sigurimet shoqerore e ato shendetesore ne organet kompetente sipas ligjit.

**B I L A N C I**

Neni 29

Bilanci mbyllet ne 31 Dhjetor te cdo viti. Llogarite vjetore, inventari,raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga ekspertet kontabel te autorizuar nga administratori miratohen nga asambleja e ortakeve.

Miratimi I dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati tre mujor nga data e mbylljes se vitit financiar.

Neni 30

Pas miratimit te llogarise vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimit , qe perbehet nga fitimi I vitit financiarte cilit I jane zbritur shumat e lena per fondin rezerve si edhe te fondeve te tjera qe shihen te nevojeshme si edhe humbjet asambleja e ortakeve percakton edhe dividentet e realizuar mbi fitimin.

**SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI**

Neni 31

Shoqeria mbaron me vendim te asamblese se ortakeve ose kur ka nje prishje te parakohshme per arsyet e parashikuara ne ligj.

Neni 32

Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit qysh nemomentin e prishjes se saj.Per kryerjen e ketij procesi asamblea e ortakeve cakton nje ose disa likujdues te cilet I paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit te shoqerise ,mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe afatin e nevojshem te perfundimit te tyre .Ne fund te procesit te likuidimit asamblea e ortakeve vendos mbi bilancin perfundimtar financiar dhe mbylljen e procesit te likuidimit .Pas pagimit te likuidatoreve asamblea e ortakeve ben ndarjen e pjeses se mbetur te kapitalit .

**ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

Neni 33

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate aktivitetit te shoqerise ose gjate procesit te likuidimit ,ne qofte se nuk do te zgjidhen ne rrugen e bisedimeve do te zgjidhet nga Gjykata e rrethit Fier.

**DISPOZITA TE FUNDIT**

Neni 34

Shtimi I ortakeve

Kur ortaket jane dakort qe te behen shtesa kapitali me ane te personave te tjere qe keta te konsiderohen ortake duhet te veprohet si me poshte :

1- Merret vendimi nga ortaket themelues ,ku shqyrtohet kerkesa e te interesuarit ,behet pranimi dhe percaktohet kuota e kapitalit qe do te derdhe ortaku i ardhshem.
2- Behet regjistrimi ne librin e ortakeve ,ku shenohet emri I plote I ortakut dhe kuota e tij ne shoqeri.
3- Veprimi I bashkimit me ortakun e ri duhet te behet me akt noterial.

Neni 35

Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen me te njejten procedure te miratimit fillestar te tij.

Ndryshimet nuk prekin personalitetin juridik te shoqerise.
Statuti eshte hartuar ne kater kopje origjinale,nga te cilat njera depozitohet ne Gjykaten e Tiranes .

**ORTAKET E SHOQERISE "ELVA 2001" SH.P.K.FIER**

LUAN HASANBASHA VOJSAVA HUDHRA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE FIER
NOTERE VEZIRE DUSHI
N325 rep.

VERTETIM FIRME

Sot ne Fier dt.13.02.2001,perpara meje noteres Vezire Dushi , me zyre noterie ne qytetin e Fierit u paraqiten personalisht shtetasit :
LUAN HASANBASHA ,I biri I Hysniut ,dtl.1963 ,lindur ne Kasnice e banues ne Fier ,lagja "1 Maj"me zotesi te plote juridike e per te vepruar ,identifikuar me pas.nr.0149826;
VOJSAVA HUDHRA , e bija e Kasemit ,dtl.1953 ,lindur ne e banuese ne Fier ,lagja " 1 Maj" ,me zotesi te plote juridike e per te vepruar ,identifikuar me pas.nr,0222547
Te cilet me vullnet te lire dhe deshire te plote firmosen ne prezencen time statutin e mesiperm te shoqerise "ELVA 2001" sh.p.k.Fier . Une noter vertetoj sa me siper duke e nenshkruar ate sipas ligjit.

NOTERE
VEZIRE DUSHI

PULLE TAKSE
100
LEKE
R.SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NOTERE PUBLIKE ILDA SHARRA
NR 476 REP

PULLE TAKSE

**VERTETIM NENSHKRIMI**

Ne Tirane sot me date 29/12/2005, vertetoj se para meje noteres ILDA SHARRA me seli ne Rrugen « Sami Frasheri « ,u paraqit personalisht :

- **Kastrot Haxhaj** lindur e banues ne Fier , madhore ,me zotesi te plote per te vepruar , njohur prej meje noteres personalisht, me cilesine e Ekspertit Kontabel te Autorizuar(pjisur me Licensen Nr 22 date 10/02/2000 leshuar nga (IEKA ), i cili e nenshkroi ne prezencen time noteres aktin bashkangjitur me vullnetin e tij te lire dhe te plote .

Une NOTERE ILDA SHARRA e vertetoj rregullisht.

**NOTERE ILDA SHARRA**

# R A P O R T EKSPERTIT KONTABEL
# TE SHNDERIMIT

**"ELVA 2001"**

Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar

Me kapital themeltar 100.000 leke

Me seli : FIER

**Raport i Ekspertit Kontabel te Autorizuar**

**I parashikuar nga nenet**

**E ligjit Nr 7638 date 19.12.1992**

**Kastriot Haxhaj**

**Ekspert Kontabel i Autorizuar**

**Adresa: Ndertesa perball Telekomit Fier**

**Ortakevete shoqerise "ELVA 2001" z Mihal Hudhra dhe z.Vojsava Hudhra**

**Te nderuar ortake .**

**Me vendim te Gjykates Shkalles se Pare Tirane Nr 25441/2 date 31.01.aa mare ne baze te kerkeses se administratorit z Mihal Hudhra ne kuadrin e projektit per shnderimin e shoqerise tuaj ne shoqeri anonime, jam caktuar si ekspert i ngarkuar me dy misione njeheresh ate te parashikuar nga neni 73 te ligjit "Per shoqerite tregetare" dhe misionin e parashikuar nga neni 77 i te njejtit ligj.**

**Une kam nderin tu raportoj juve per ekzekutimin e ketyre misioneve te cilat konsistojne nga njera ane ne paraqitjen e nje raporti per gjendjen e shoqerise (neni 73) dhe nga ana tjeter , ne vleresimin e vlerave te pasurive qe perbejne aktivin e shoqerise dhe avantazhet e vecanta qe mund te ekzistojne ne perfitim te ortakeve ose te treteve (neni 77) dhe verifikimin qe shuma e kapitaleve te veta eshte te pakten e barabarte me ate te kapitalt themeltar.**

**Per kryerjen e ketyre misioneve ne kemi disponuar bilancet e shoqerise te hartuar per daten 31.12.2004 date e mbylljes se ushtrimit te fundit, si dhe dokumente te tjera te nevojshme per kontrollin e elementeve te ketij bilanci.**

Kontrollet e mia u kryen pjeserisht ne ambjentet e shoqerise ne zyren ku hartohen bilancet dhe dokumentat kontabel si dhe ne seline e shoqerise ku na u dhane spjegime dhe justifikime plotesuse per element te bilanceve te shqyrtuara si dhe per evolimin e situates se shoqerise qysh nga data e mbylljes se ushtrimit financiar te fundit.

Ne baze te hapave te ndermara e te punes se kryer ne jemi ne gjendje tu bejme te njohur perfundimet qe vijojne ne kuadrin e raporteve te parashikuara nga ligji.

1 Mbi gjendjen e shoqerise

Nga shqyrtimi i bilancit te fundit del qe shoqeria ka realizuar me fitime gjate viteve te meparshme dhe ate te ushtrimit financiare dhe konkretisht :

Fitime te mbartura para vitit 2004 per 2.569.058 leke

Fitim i Ushtrimi 2004 1.479.798 leke

Duke patur parasysh qe rezultatit e meparshme dhe ate te ushtrimit te mbyllur deri me 31 dhjetor 2004 nuk jane shperndare dhe paraqiten ne vleren 4.148.856 leke si dhe shtohen shuma e arketuar me banke per efekt ritje kapitali te bere me mandat arketimi Nr 0149375 ne shumen 2.000.000 leke atehere kapitalet e veta arrijne , ne kete date ne shumen 6.148.856 leke dhe perbehen si vijon:

Kapitali themeltar 5.00.000 leke

Rezerva 500.000 leke

Fitime te pashperndara 648.856 leke

Per sa jemi ne dijeni dhe sipas elementeve te cmuar qe kemi disponuar, asnje fakt i natyres qe ndryshon ndjeshem ( ne menyre materiale) shumen e kapitaleve te veta te treguar me siper nuk ka ndodhur qysh nga data e mbylljes se ushtrimit financiar te fundit. Si konkluzion llogarite vjetore qe ne kemi shqyrtuar shprehin sipas mendimit tim , ne menyre korrekte situaten financiare dhe pasurore te shoqerise, natyrisht e cmuar kjo ne kuadrin e vijimesise te veprimtarise.

Ne rafshin juridik ne ju rikujtojme se nje shoqeri me pergjegjsi te kufizuar per transformuar ne shoqeri anonime duhet te permbushe kushtet per kete te fundit lidhur me shumen e kapitalit themeltar . Ky kapital duhet te jete te pakten dy milion leke .

Duke qene se ky kusht eshte plotesuar deri ne diten e sotme, atehere eshte e realizushme mundesia e trasformimit te projektuar.

2 Mbi vleren e pasurive qe perbejne aktivin e shoqerise dhe avantazhet e vecanta.

A) Vlera e pasurive qe perbejne aktivin e shoqerise.

Per shkak te natyres se vecante te operacionit te projektuar misioni yne i verifikimit kosistonte novojshmerisht jo aq per te vleresuar peshen (rendesine, materialitetin) e plus vlerave evidente te fsheta, se sa per tu siguruar qe vlera kontabel per te cilat ortaku te marri nje vendim qe nuk cojne, ne nje mbivleresim te pasurise se shoqerise.Theksojme se aktivet e inventariale jane vleresuar me kostot e blerjes.

Aktivi i shoqerise i pasqyruar ne bilanc perbehej nga elementet si vijojne

Aktive te qendrushme te trupezuara 259.449 leke

| | |
|---|---|
| Aktive qarkulluse inventariale | 1.666.689 leke |
| Aktive kerkesa per arketim | 709.832 leke |
| Likuiditete | 1.550.992 leke |
| totali | 4.186.962 leke |

Ne kunderparti detyrimet

e kerkushme arin ne : 38.106 leke

- Aktivi neto kontabel rezultonte keshtu: 4.148.856 leke

Vleresimi i cdo posti te aktivit dhe te pasivit ka bere objekt te nje shqyrtimi te vemendshem ne kushtet e paraqitura ketu me poshte.

AKTIVE TE QENDRUSHME

Elemente te trupezuar ne bilancit te 31 dhjetorit 2004 figurojne ne vleren 259.449 dhe perfaqson vleren e nje automjeti vleresuar sipas cmimit te

blerjes dhe justifikuar me kontraten e blerjes.

AKTIVI QARKULLUS DHE PASIVI I KERKUSHEM

Shqyrtimi (verifikimi) si per postet e aktiveve qarkulluse dhe per pasivet e kerkushme nuk ka nxjere asgje jonormale duke patur parasysh qe deri ne daten e nderhyrjes tone nuk morem ne dijeni per ndonje konflikt ose rezik te mundshem per ta ndryshuar situaten e shoqerise.

PERFUNDIM:

Ne perfundim te verifikimeve te bera dhe duke patur parasysh hollesite e dhena me siper ne cmojme qe vlera neto kontabel elementeve qe perbejne aktivin e shoqerise, ashtu sic dalin keto vlera nga pasqyrat financiare qe i jane aneksuar ketij raporti jane ne pajtushmeri me regullat dhe parimet kontabel ne fuqi dhe perbejne nje vleresim normal dhe te arsyeshem. Keshtu qe ne kuadrin e vecante te operacionit te shnderimit ky vleresim mund ti paraqitet per miratim asamblese se pergjithshme.

B) Avantazhet e vecanta :

Nuk na u sinjalizua dhe une vete , nuk zbulova, gjate kontrolleve te kryera asnje avantazh te vecante ne perfitim te ortakut ose te te treteve.

C) Kapitalet e veta dhe kapitali themeltar

Per tu konfirmuar me ligjin ne vertetojme se shuma e kapitaleve te veta te shoqerise ,e cmuar ne baze te dokumentave per gjendjen me 31.12.2004. te cilat na u konfirmuan dhe i verifikuam eshte me e larte nga ajo e kapitalit themeltar te shoqerise ne formen juridike te sotme.

Eksperti i Shnderimit
Kastriot Haxhaj
Fier me

EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR - KASTRIOT HAXHAJ

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTEREVE TIRANE**
**Nr.** 485 **Rep.**
**Nr.** 57 **Kol.**

VERTETIM

Ne Tirane, sot me 29 Dhejtor 2005, perpara meje, Noteres Ilda V. Sharra u paraqiten personalisht:

Mihal Hudhra dhe Vojsava Hudhra, ne cilesine e aksionereve te shoqerise Anonime " ELVA 2001 " sha

Personat e mesiperm jane shtetas shqiptare, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar te njohur personalisht prej meje.

Pasi deklaruan se statuti dhe akti I themelimit te mesiperm eshte hartuar jashte kesaj zyre ne perputhje te plote me vullnetin e tyre te lire, e nenshkruan rregullisht para meje Noteri, gje te cilen e vertetoj sipas ligjit shqiptar.

NOTERE

ILDA V. SHARRA

25441/3

KERKESE

KERKUES : Mihal Hudhra, shtetas shqiptar, madhore me zotesi per te vepruar, administrator I shoqerise " ELVA 2001 " Sha.

OBJEKTI : Depozitimin e vendimit nr. 2 date 29.12.2005, te Asamblese se Aksionereve te shoqerise " ELVA 2001 " sha.

BAZA LIGJORE : Ligji 7667 date 28.01.1993 " Per Regjistrin Tregtar " dhe ligji 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare ".

DREJTUAR
GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR TIRANE

Shoqeria "**ELVA 2001** " shpk eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr. 25441 date 15.03.2003 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.
Sipas dokumentacionit te depozituar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, ne Zyren e Regjistrit Tregtar, ortak te shoqerise jane Mihal Hudhra dhe Vojsava Hudhra, administrator I shoqerise eshte Mihal Hudhra, kapitali I shoqerise eshte 100.000 leke.
Me vendimin nr. 1 date 20.12.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise eshte vendosur :

- Shnderimi I shoqerise " ELVA 2001 " shpk nga nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne nje shoqeri Anonime.
- Rritja e kapitalit te shoqerise , per arritjen e kufirit te lejuar nga ligji per krijimin e shoqerive anonime.
- Emerimin e z. Kastriot Haxhaj, anetar I IKEA, me profesion ekspert kontabel I autorizuar, me nr. Licence 22 date 10.02.2000, per kryerjen e raportit te ekspertimit I cili do te evidentoje rritjen e kapitalit te shoqerise.

Me vendimin nr. 2 date 29.12.2005 te Asamblese se Aksionereve te Shoqerise «ELVA«r sha eshte vendosur :

- Miratimi I raportit te ekspertit kontabel te autorizuar per rritjen e kapitalit te shoqerise.
- Rritja e kapitalit te shoqerise.
- Miratimin e bilanceve financiare te dy viteve te fundit.
- Shnderimin e shoqerise nga nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne nje shoqeri anonime.
- Miratimin e statutit dhe aktit te themelimit te ri

Ne mbeshtetje te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 « Per Shoqerite Tregtare » dhe ligjit 7667 date 28.01.1993 " Per Regjistrin Tregtar ", kerkohej depozitimin e vendimit nr. 2 date 29.12.2005 te Asamblese se Aksionereve te Shoqerise " ELVA 2001 " shpk , statutit dhe aktit te ri te themelimit, prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, ne Zyren e Regjistrit Tregtar, per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

DREJTOR

MIHAL HUDHRA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 473 Rep.

VERTETIM

Ne Fier , sot me date 29.12.2005, perpara meje noteres ILDA SHARRA , u paraqit personalisht shtetasi MIHAL HUDHRA , drejtor I shoqerise "ELVA 2001 " sha, shtetas shqiptar, madhore me zotesi per te vepruar, I cili deklaroi se kerkesa e mesiperme eshte hartuar jashte kesaj zyre, me vullnet te plote e te lire, I cili nenshkroi rregullisht para meje dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit..

NOTERE
ILDA V. SHARRA

**VENDIM**
**I KESHILLIT MBIKQYRES**
**TE SHOQERISE " ELVA 2001 " SHA**
**Date 29/12/2005**

Sot me date 29/12/2005, ne seline e shoqerise u zhvillua mbledhja e Keshillit Mbikqyres te shoqerise te perbere nga Vojsava Hudhra Kastriot Gishti Eltion Hudhra ,me rend dite si me poshte :

1. Zgjedhjen e drejtorit te pergjithshem te shoqerise " ELVA 2001" SH.A.
2. Zgjedhjen e kryetarit te Keshillit Mbikqyres.

Mbas shqyrtimit Keshilli Mbikqyres I Shoqerise

**V E N D O S I**

Emerimin me detyren e **drejtorit te pergjithshem te shoqerise " ELVA 2001 " sha**
**Z. MIHAL HUDHRA .**
Zgjedhjen ne detyren e kryetarit te keshillit mbikqyres te znj. Vojsava Hudhra.

Ngarkohet drejtori i shoqerise te ndjeke procedurat ligjore per depozitimin e ketij vendimi prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane ne Zyren e Rregjistrit Tregetar .

**ANETARET E KESHILLIT MBIKQYRES**

| Vojsava Hudhra | Kastriot Gishti | Eltion Hudhra . |
|---|---|---|
| Vojsava Hudhra | Kastriot Gishti | Eltion Hudhra |

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 474 Rep.

PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

VERTETIM

Ne Fier, sot me date 29/12/2005, perpara meje noteres ILDA SHARRA , u paraqiten personalisht shtetasit Vojsava Hudhra, Kastriot Gishti dhe Eltion Hudhra me cilesine e anatereve te keshillit mbikqyres te shoqerise " ELVA 2001 " sha, shtetas shqiptar, madhore me zotesi per te vepruar, te njohur personalisht prej meje, te cilet deklaruan se akti I mesiperm eshte hartuar jashte kesaj zyre, me vullnet te plote e te lire, te cilet nenshkruan rregullisht para meje dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit..

NOTERE
ILDA V .SHARRA

REPUBLIKA E SHQIPERISE ILDA V. SHARRA NOTER TIRANË

# VENDIM
## I ASAMBLESE SE AKSIONEREVE TË SHOQERISE " ELVA 2001 "SHA
Date 29/12/2005

Ne Fier, sot me date 29/12/2005, ne seline e shoqerise, me pjesemarrjen e 100 % te kapitalit te shoqerise te zoteruar nga ortaket Mihal Hudhra dhe Vojsava Hudhra, u zhvillua mbledhja e aksionereve te shoqerise me rend dite si me poshte :
-Analiza dhe shqyrtimi I raportit te paraqitur nga eksperti kontabel I autorizuar, per rritjen e kapitalit themeltar te shoqerise.
-Shqyrtimi I bilanceve financiare te te dy viteve te fundit.
-Shnderimi I shoqerise nga nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne nje shoqeri anonime.
- Miratimi i statutit dhe aktit te ri te themelimit.
Mbas shqyrtimit shoqeria , unanimisht,

## VENDOSI:

- Miratimin e raportit te ekspertit kontabel te autorizuar per rritjen e kapitalit te shoqerise.
- Rritja e kapitalit te shoqerise nga 100.000 leke ne 5.000.000 leke, duke ruajtur te pandryshuar zoterimin e aksioneve te aksionereve ne shoqeri, si me poshte :
  Mihal Hudhra zoterues i 50 % te kapitalit te shoqerise me vlere 2.500.000 leke dhe
  Vojsava Hudhra zoteruese e 50 % te kapitalit te shoqerise me vlere 2.500.000 leke.
- Miratimin e bilanceve financiare te dy viteve te fundit.
- Shnderimin e shoqerise nga nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne nje shoqeri anonime.
- Miratimin e statutit dhe aktit te ri te themelimit.
- Zgjedhjen e keshillit mbikqyres te perbere nga :
  Vojsava Hudhra
  Kastriot Gishti
  Eltion Hudhra .
  Miratimin e objektit te ri te shoqerise si me poshte:

- **Import –eksport, transport, tregetim me shumice I naftes brutt, gazit natyror, gazit te lengshem, I nenprodukteve te perpunuara te naftes si benzine, benzine avionash ,gazoil, vajguri ndricues, vajguri avionash, aromatike, solevent, white spirit, lende djegese solar, mazut, bitum, koks nafte, squfur, vajra lubrifikante etj.**
- **Shoqeria mund te krijoje studime dhe asistence teknike, kerkimore dhe shkencore ne fushen e nxjerrjes dhe perpunimit te naftes dhe gazit ,analizat laboratorike te te gjitha nenprodukteve te naftes .**
- **Import –eksport, tregetim me shumice lendeve te para, makineri, produkte te fushes se industrise mekanike, elektrike, ndertimit, kimike ushqimore etj.**
- **Investitor privat ne fushen e ndertimeve publike, shteterore, civile etj.**
- **Selia e shoqerise eshte ne Fier, lagjja "1 Maj".**

Ngarkohet drejtori i shoqerise te depozitoje vendimin e mesiperm prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, ne Zyren e Regjistrit Tregtar.

ASAMBLEJA E AKSIONEREVE

MIHAL HUDHRA

Mihal Hudhra

VOJSAVA HUDHRA

Vojsava Hudhra

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 478 Rep.

VERTETIM

Ne Fier , sot me date 29/12/2005, perpara meje noteres ILDA SHARRA , u paraqiten personalisht shtetasit Mihal Hudhra dhe Vojsava Hudhra me cilesine e aksionereve te shoqerise "ELVA 2001 " sha, shtetas shqiptar, madhore me zotesi per te vepruar, te njohur personalisht prej meje, te cilet deklaruan se akti I mesiperm eshte hartuar jashte kesaj zyre, me vullnet te plote e te lire, te cilet nenshkruan rregullisht para meje dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit..

NOTERE
ILDA V .SHARRA

PULLE TAKSE
100
LEKE
R. SHQIPERISE

KERKESE

KERKUES : Mihal Hudhra, shtetas shqiptar, madhore me zotesi per te vepruar, administrator I shoqerise **" ELVA 2001 " shpk.**

OBJEKTI : Depozitimin e vendimit nr. 1 date 20.12.2005 te Asamblese se ortakeve te shoqerise ""**ELVA 2001**" shpk.

BAZA LIGJORE : Ligji 7667 date 28.01.1993 " Per Regjistrin Tregtar " dhe ligji 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare ".

DREJTUAR
GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR TIRANE

Shoqeria "**ELVA 2001** " shpk eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr. 25441 date 15.03.2003 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.
Sipas dokumentacionit te depozituar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, ne Zyren e Regjistrit Tregtar, ortak te shoqerise jane Mihal Hudhra dhe Vojsava Hudhra, administrator I shoqerise eshte Mihal Hudhra, kapitali I shoqerise eshte 100.000 leke.
Me vendimin nr. 1 date 20.12.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise eshte vendosur :

- Shnderimi I shoqerise " ELVA 2001 " shpk nga nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne nje shoqeri Anonime.
- Rritja e kapitalit te shoqerise , per arritjen e kufirit te lejuar nga ligji per krijimin e shoqerive anonime.
- Emerimin e z. Kastriot Haxhaj, anetar I IKEA, me profesion ekspert kontabel I autorizuar, me nr. Licence 22 date 10.02.2000, per kryerjen e raportit te ekspertimit I cili do te evidentoje rritjen e kapitalit te shoqerise.

Ne mbeshtetje te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 « Per Shoqerite Tregtare « dhe ligjit 7667 date 28.01.1993 " Per Regjistrin Tregtar ", kerkohej depozitimin e vendimit nr. 1 date 20.12.2005 te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise " ELVA 2001 " shpk prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, ne Zyren e Regjistrit Tregtar, per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

ADMINISTRATOR

Mihal HUDHRA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 443 Rep.

PULLE TAKSE 100 LEKE

VERTETIM

Ne Fier , sot me date 20.12.2005, perpara meje noteres ILDA SHARRA , u paraqit personalisht shtetasi Mihal Hudhra, administrator I shoqerise "ELVA 2001 " shpk, shtetas shqiptar, madhore me zotesi per te vepruar, I cili deklaroi se kerkesa e mesiperme eshte hartuar jashte kesaj zyre, me vullnet te plote e te lire, I cili nenshkroi rregullisht para meje dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit..

NOTERE

ILDA V. SHARRA

SHOQERIA " ELVA 2001 " SHPK

VENDIM
I ASAMBLESE SE ORTAKEVE
TË SHOQERISE " ELVA 2001 " SH.P.K.
Date 20.12.2005

Ne Tirane, sot me date 20.12.2005, ne seline e shoqerise " ELVA 2001 " shpk, u zhvillua mbledhja e Asamblese se Ortakeve te shoqerise , me pjesmarrjen e te dy ortakeve Mihal Hudhra dhe Vojsava Hudhra qe perfaqesojne 100 % te kapitalit te shoqerise, me rend dite si me poshte :

1. Shnderimi I shoqerise " ELVA 2001 " shpk nga nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne nje shoqeri Anonime.

Mbas shqyrtimit te kushteve dhe mundesive per realizimin e ketij shnderimi Asambleja e Ortakeve,

VENDOSI

- Shnderimin e shoqerise " ELVA 2001 " shpk nga nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne nje shoqeri Anonime.
- Rritjen e kapitalit te shoqerise , per arritjen e kufirit te lejuar nga ligji per krijimin e shoqerive anonime.
- Emerimin e z. Kastriot Haxhaj, anetar I IKEA, me profesion ekspert kontabel I autorizuar, me nr. Licence 22 date 10.02.2000, per kryerjen e raportit te ekspertimit I cili do te evidentoje rritjen e kapitalit te shoqerise.

Ne mbeshtetje te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 « Per Shoqerite Tregtare « dhe ligjit 7667 date 28.01.1993 " Per Regjistrin Tregtar ", ngarkohet administratori I shoqerise z. Mihal Hudhra te depozitoje kete te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise " ELVA 2001 " shpk prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, ne Zyren e Regjistrit Tregtar, per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

MIHAL HUDHRA

VOJSAVA HUDHRA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE FIER
Nr. 444 Rep.

VERTETIM

Ne Fier , sot me date 20.12.2005, perpara meje noteres ILDA SHARRA u paraqiten personalisht shtetasit Mihal Hudhra dhe Vojsava Hudhra, te dy ortak te shoqerise " ELVA 2001 " shpk, shtetas shqiptar, te dy madhore me zotesi per te vepruar, te cilet deklaruan se vendimi i mesiperm eshte hartuar jashte kesaj zyre, me vullnetin e tyre te lire e te plote, dhe e nenshkruan rregullisht para meje dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit..

NOTERE
ILDA SHARRA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA TREGTARE "ELVA 2001"SHPK FIER
ASAMBLEJA E ORTAKEVE

# V E N D I M
## NR.2 DATE 21.02.2002

Ne Fier,sot me date 21.02.2002 u mblodh Asambleja e Ortakeve te Shoqerise te Tregtare "Elva 2001"shpk Fier e perbere nga dy ortaket e saj Mihal Hudhra dhe Vojsava Hudhra.Asambleja analizoi treguesit ekonomik e financiar te kesaj shoqerie tregtare dhe ceshtjen e caktimit te administratorit,mbasi dha doreheqjene administratori i meparshem zoti Luan Hasanbasha.

Nga diskutimet doli se krahas aktivitetit ekzistues,eshte mundesia per tu zgjeruar dhe te shtohet objekti i veprimtarise.Keshtu krahas transportit e tregtimit me pakice te nenprodukteve te naftes si bitum,solar,mazut,lubrifikante etj te kesaj natyre,ekzistojne kushtet dhe mundesite qe te kete ne objektin e saj te veprimtarise edhe importin e eksportin e prodhimeve dhe artikujve te ndryshem te mallrave ushqimor,industrial,pajisje e makineri te fushes mekanike,te ndertimit,produkteve kimike,me shumice dhe pakice.

Ndersa persa i takon administratorit te Shoqerise Tregtare duke marre parasysh profesionalizmin dhe aftesite e tij,u caktua te jete zoti Mihal Hudhra,i cili njekohesisht eshte dhe njeri nga dy ortaket e saj.

Ne unanimitet Asambleja e Ortakeve ne perfundim te diskutimeve,

VENDOSI:

1.Te beje shtese te objektit te veprimtarise krahas asaj ekzistuese edhe import eksport te prodhimeve e artikujve te ndryshem,ushqimore,industriale,pajisje e makineri te fushes mekanike,te ndertimit,produkteve kimike,shitje te tyre,me shumice dhe pakice.

2.Te caktoj administrator te Shoqerise Tregtare "Elva 2001"shpk Fier zotin Mihal Hudhra.

3.Vendimi eshte pjese perberese e akteve dokumentare te kesaj shoqerie tregtare.

4.Te depozitohet vendimi ne regjistrin tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare te Rrethit Tirane.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

1.MIHAL HUDHRA 2.VOJSAVA HUDHRA

MIHAL HUDHRA Vojsava Hudhra

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA
NR. 177 rep
Nr. 75 kol

# KONTRATE SHITJE KUOTASH

Ne, Fier, ,sot me date 20.02 2002 perpara meje noterit u paraqiten personat e meposhtem dhe bene kete kontrate shitje kuotash:

SHITESI:LUAN HYSNI HASANBASHA,i vitlindjes 1963,banues ne lagjen "1 maj"te qytetit Fier,me zotesi te plote juridike per te vepruar,njohur me pasaporte personale nr.0149826.

BLERESI:MIHAL MITI HUDHRA,i vitlindjes 1953,banues ne lagjen "Apolonia" te qytetit Fier,me zotesi juridike te plote per te vepruar,njohur me pasaporte personale nr.1067499.

Ata deklaruan: Une,shitesi Luan Hasanbasha jam njeri nga dy ortaket e shoqerise tregtare "Elva 2001" shpk Fier,e cila eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr.25441 date 15.03.2001 te Gjykates se shkalles se Pare te Rrethit Tirane.Zotroj 50 perqind te kapitalit themeltar prej 100000(njeqindmije) lekesh.Me vullnet te lire keto kuota kapitali ia shes blersit zotit Mihal Hudhra,ne shumen prej 50000(pesedhjetemije) lekesh,te cilat ai m'i ka shlyer teresisht jashte kesaj zyre.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate nga te dy palet une shitesi nuk kam asnje pretendim ndaj kesaj shoqerie tregtare,sikurse humb te gjitha te drejtat e mija ne kete shoqerie tregtare;ato i kalojne bleresit te ketyre kuotave zotit Mihal Hudhra.

Une, bleresi Mihal Hudhra deklaroj se sa thote shitesi jane te verteta veprimet e mesiperme jane kryer prej meje,kam blere nga zoti Luan Hasanbasha kuotat e tij te pjesmarrjes ne kapitalin themeltar te shoqerise tregtare "Elva 2001"shpk Fier.Ne kete menyre behem njeri nga dy ortaket e saj,se bashku me ortaken tjeter Vojsava Hudhra.Ne kete menyre tek shoqeria tregtare e permendur ngelen vetem dy ortake,me pjesmarrje te barabarte ne kapital,perkatesisht zoti Mihal Hudhra me 50 perqind dhe zonja Vojsava Hudhra me pjesmarrje te njejte ne kapitalin themeltar.

Kontrata lexohet dhe nenshkruhet me vullnet te lire te paleve ne prani te noterit,une noteri e vertetoj rregullisht sipasligjit.

| SHITESI | BLERESI | NOTERI |
|---|---|---|
| LUAN HASANBASHA | MIHAL HUDHRA | |
| Luan Hasanbasha | MIHAL HUDHRA | |

PULLE TAKSE
100 LEKE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTER
FIER

2544/1 Fier,me 21.02. 2002

KERKESE

KERKUESI:MIHAL MITI HUDHRA,I vitlindjes 1953,banues ne lagjen "apolonia" te qytetit Fier,me kombesi e shtetesi shqiptare.

OBJEKTI: Kerkoj depozitimin e vendimeve nr.1 date 20.02.2002dhe nr.2 date 21.02.2002 te Asamblese se Ortakeve te Shoq.Treg."elva 2001"shpk Fiersi kontrates se shitjes se kuotave date 21.02.2002.

BAZA LIGJORE:Ligji 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligji 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TE RRETHIT

TIRANE

Une,kerkuesi Mihal Hudhra jam administrator I shoqerise tregtare "Elva 2001"shpk Fier,e cila eshte njohur person juridik me vendimin nr.25441 date 15.03.2001 te Gjykates se Shkalles se Pare te rrethit Tirane.

Asambleja e Ortakeve te kesaj shoqerie me vendimin nr.1 date 20.02.2002 ka vendosur miratimin e largimit nga ajo te ortakut Luan Hasanbasha ,I cili kuotat e tij ia shiti ortakut te ri Mihal Hudhra me anen e kontrates se shitjes nr. 177/75 date 212.02.2002.Po ashtu me kete vendim u pranua dhe doreheqja e Luan Hasanbashes si administrator.Ndersa me vendimin nr.2 date 21.02.2002 asambleja e ortakeve vendosi te caktoj si administarator Mihal Hudhren,por dhe te shtoje objektin e veprimtarise se saj edhe per import eksport te prodhimeve dhe artikujve te ndryshem,ushqimor,uindustriale,pajisje e makineri te fushes mekanike,te ndertimit,pproduktevekimike,shitje te tyre,me shumice e pakice.

Persa me lart kerkoj qe aktet e permendura te depozitohen ne regjistrin tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare te Rrethit Tirane.

Bashkengjitur nga nje kopje e cdo akti qe shenohet me siper.

KERKUESI
MIHAL HUDHRA
Mihal Hudhra

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA
Nr. 179 rep.

VERTETIM

Sot,me date 21.02. 2002,perpara meje noterit u paraqit z.MIHAL MITI HUDHRA,I vitlindjes 1953,banues ne lagjen "Apolonia" Fier,me zotesi te plote juridike per te vepruar,njohur me pasaporte personale nr.1067499.Ai deklaroi se kete kerkese e ka bere vete dhe nenshkruan me vullnet te liore ne pranine tim,une noiteri e vertetoj rregullisht sipas ligjit.

NOTERI
Vezire Dushku

PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA TREGTARE 'ELVA 2001"SHPK FIER
ASAMBLEJA E ORTAKEVE

VENDIM
NR.1 DATE 20.02.2002

Ne Fier,sot me date 20.02.2002 u mblodh Asambleja e Ortakeve te Shoqerise Tregtare "Elva 2001" shpk Fier,e cila eshte regjistruar person juridik me vendimin nr.25441 date 15.03.2001 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Asambleja e Ortakeve shqyrtoi kerkesen e njerit nga dy prej ortakeve te saj,qe zoteron 50 perqind te kapitalit .Konkretisht te zotit Luan Hasanbasha i cili kerkon te largohet teresisht nga kjo shoqeri tregtare,duke i shitur kuotat e veta te pjesmarrjes ne kapitalin e saj,tek zoti Mihal Hudhra qe gjithashtu kerkon t'ia bleje.Ne keto kushte Asambleja e Ortakeve bie dakord me kerkesen e Mihal Hudhres qe ky te pranohet ortak i Shoqerise Tregtare "Elva 2001"shpk Fier.

Nderkohe ortaku Luan Hasanbasha ne kete mbledhje paraqiti edhe doreheqjen e vet si administrator i Shoqerise Tregtare "Elva 2001"shpk Fier.

Ne perfundim te diskutimeve Asambleja e Ortakeve,ne menyre unanime,mbeshtetur ne nenin 19 dhe 21 te statutit te shoqerise tregtare ne fjale,

VENDOSI:

1.Te miratoj largimin e plote nga kjo shoqeri tregtare te ortakut Luan Hasanbasha dhe te pranoj ne vend te tij si ortak zotin Mihal Hudhra,me pjesmarrje ne kapital 50 perqind .Midis tyre te behet kontrata e shitjes se kuotave te pjesmarrjes ne kapitalin themeltar.

2.Te pranoj doreheqjen e zotit Luan Hasanbasha nga detyra e administratorit te shoqerise tregtare "Elva 2001"shpk Fier.

3.Ky vendim te konsiderohet pjese perberese e dokumenteve themeltare te kesaj shoqerie tregtare.

4.Te kryhen veprimet perkatese ne rregjistrin tregtar prane Gjykates se shkalles se Pare te Rrethit Tirane.

ORTAKET E SHOQ.TREG."ELVA 2001" SHPK FIER

| | |
|---|---|
| 1.LUAN HASANBASHA | 2.VOJSAVA HUDHRA |
| Luan Hasanbasha | Vojsava Hudhra |

**FORMULARI I SIGURIMIT TE OFERTES**
**GARANCI BANKARE**

Nr.ref                                                                 Data 09/02/2001

Me kete dokument vertetojme se Niazi Hoxha Kosta
ka derdhur prane deges se Bankes se Kursimeve Fier, shumen prej
100.000 leke (njeqind mije)
si kusht per sigurimin e ofertes se paraqitur ne tenderin
Tenderi firma SHPK

Banka merr persiper te kaloje ne llogarine e Gjykata Tirane
kete Garanci Bankare ne rast se:

1.Pjesmarresi ne tender terheq oferten pa mbarim afati i vlefshmerise se ofertes.

2.Heq dore nga lidhja e kontrates, nese shpallet fitues.

3.Nuk paraqet garancine e kontrates.

me paraqitjen e kerkeses se pare me shrim nga ana e entit prokurues, pa kerkuar shpjegime, me kusht qe ne kerkese te permendet mosplotesimi i nje prej kushteve te mesiperme.

Kjo garanci eshte e vlefshme deri ne daten qe perfshin 30 dite nga mbarimi i afatit te vlefshmerise se ofertes.

Maksim DHIMITRI

DREJTORI I DEGES

PULLE TAKSE R.SHQIPERISE 100 LEKE

**[KERK]UES**

LUAN HASANBASHA I biri I Hysniut I dtl.10.05.1963,lindur ne Kasnice . me banim ne Fier ,lagja " 1 Maj ", me zotesi te plote juridikee per te vepruar I njohur me dokument identifikimi pasaporte me nr 0149826;

VOJSAVA HUDHRA e bija e Kasemit dtl.02.10.1953 ,lindur e banuese ne Fier ,lagja " 1 Maj" me zotesi te plote juridike e per te vepruar, e martuar, e identifikuar me pasaporte me nr.0222547:

**OBJEKTI**

Kerkojme ne baze te ligjit 7638 dt.19.11.1992" Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit. Nr.7667 dt 28.01.1993 "Per rregjistrimin e personave juridike ne rregjistrin tregtar " , rregjistrimin si person juridik privat me [...] te shoqerise "ELVA 2001" SH.P.K.FIER

**[...]ES SE SHKALLES SE PARE TE RRETHIT GJYQSOR TIRANE**

[...]erpershkruarit ortake te shoqerise private me pergjegjesi te kufizuar" ELVA 2001" SH.P.K.FIER jemi banore te qytetit te Fierit . Ne baze te ligjit me nr.7638 dt.19.11.1992 " Per shoqerite tregtare " dhe te ligjit me nr.7667 dt.28.01.1993 " Per rregjistrimin e personave juridike ne rregjistrin tregtar " kemi vendosur themelimin e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar "ELVA 2001" sh.p.k. Fier duke nenshkruar perpara noterit aktin e themelimit dhe stautin e shoqerise.

Shoqeria tregtare "ELVA 2001 " sh.p.k.Fier ka administrator te saj z.Luan Hasanbasha dhe qendren e aktivitetit e ka ne qytetin e Fierit,lagja " 1 Maj".Objekti I veprimtarise se shoqerise " ELVA 2001" sh.p.k.Fier eshte"Transport e tregtim me pakice te nenprodukteve te naftes si bitum ,solar ,mazut,lubrifikante etj te kesaj natyre "

Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj mbi 10 vjet pune te njepasnjeshme me kapital fillestar ne shumen 100.000 ( njeqind mije ) leke te depozituar ne llogari te veçante ne banke.

Perfundimisht duke e konsideruar kerkesen tone te bazuar ne ligj kerkojme pranimin e saj sipas objektit.

K E R K U E S

LUAN HASANBASHA VOJSAVA HUDHRA

REUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE FIER
NOTERE VEZIRE DUSHI
NR 323 rep.

VERTETIM

Sot ne Fier ,dt 13.02.2001 ,perpara meje noteres Vezire Dushi , me zyre noterie ne qytetin e Fierit u paraqiten personalisht :LUAN HASANBASHA , I biri I Hysniut ,dtl.1963 ,lindur ne Kasnice dhe banues ne Fier ,lagja "1 Maj" me zotesi te plote juridike e per te vepruar ,identifikuar me pas.nr.0149826;VOJSAVA HUDHRA , e bija e Kasemit ,dtl.1953 ,lindur e banuese ne Fier ,lagja "1 Maj" ,me zotesi te plote juridike e per te vepruar ,identifikuar me pas. Nr.0222547 ; te cilet me vullnet te lire dhe deshire te plote firmosen ne prezencen time kerkesen e mesiperme dhe une noteri vertetoj sa me siper duke e nenshkruar

NOTERE
VEZIRE DUSHI

**BANKA e TIRANES**
**TIRANA BANK**
MEMBER OF PIRAEUS BANK GROUP

0149375

KODI FISKAL / FISCAL CODE: 3607408 NIPT / TAXE CODE: J 61924008 V

[redacted]
Rruga "Luigj Gurakuqi"

Tel: +355 4 272041 / 44

L.1 MAJ
FIER
ALBANIA

| | |
|---|---|
| Data | 30JAN06 |
| Tipi i Deal-it | Depoz.Escrow Deri ne 1 Muaj |
| Monedha | Lek |
| Refer.Llogarise | E1MSO-0149376 |
| Statusi | DEAL IRI/MODIFIK.SOT |

## K O N F I R M I M I I D E P O Z I T E S K O L A T E R A L

Konfirmojme depoziten e mbajtur si kolateral si me poshte

| | | |
|---|---|---|
| Shuma e depozites kolateral | | ALL 2,000,000.00 |
| Fillimi-Maturimi | 30JAN06-OPEN | |
| Perqindja e interesit | 0.0 | |
| Taksa e interesit% | 0.0 | |
| Ditet e inter./Baza | 29/365 | |
| Shuma totale interesit | | ALL 0.00 |
| Shuma totale e takses | | ALL 0.00 |
| Shuma neto e interesit | | ALL 0.00 |

Ne fillim
BLLOKIM SHUME SI SHTIM PER KAPITAL FILLESTAR PER ELVA 2001 SHA

Ne maturim
BLLOKIM SHUME SI SHTIM PER KAPITAL FILLESTAR PER ELVA 2001 SHA

Monika Majko

Diana Duka

Firma(t) e Autorizuar(a)

20241/10M/04-05